



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:177144

Datë: 21.06.2024

Numri i dokumentit: 05848795

KF.nr.452/2022

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtaren Vera Gashi Bala, në kontestin tregtar - administrativ të paditësit “Ballkani” Sh.P.K., me NUI 811384883 dhe seli në Viti, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Kushtrim Bytyqi, avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Dogana e Kosovës, me seli në Prishtinë, lidhur me padinë e paditësit për anulimin e vendimi, objekt kontesti rivlerësim doganor, vlera e kontestit 1,000.00 euro, në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor-publik, të mbajtur me datë 12.06.2024, në prani të përfaqësuesit të autorizuar të palës paditëse avokat Kushtrim Bytyqi dhe përfaqësuesit të palës së paditur, Krenare Shala, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET kërkesëpadia e paditësit “Ballkani” Sh.P.K. me numër unik identifikues 811384883 dhe seli në Viti, si e bazuar.
- II. ANULOHET aktvendimi me nr. nr.01.3.2.2/9474; 8088, i datës 30.06.2021 i Doganës së Kosovës me seli në Prishtinë, dhe çështja i kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje të njëjtës.
- III. Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi, me padinë e paraqitur në Gjykatë më 10.08.2021, ka iniciuar kontestin tregtar-administrativ kundër të paditurës Dogana e Kosovës, duke kërkuar anulimin e vendimit nr.01.3.2.2/9474; 8088, të datës 30.06.2021. Si në padi ashtu edhe në seancat gjyqësore, deklaroi se e paditura me aktvendimin e atakuar ka bërë shkelje ligjore të referuara në padi, përkatësisht

nenit 33 të KDAK lidhur me nenin 123 të UA 11/2009. Më tej ka shtuar se paditësi ka prezantuar dokumente relevante për të vërtetuar çmimin e transaksionit, ndërsa urdhërpagesat bankare në emër të faturave të mallrave i ka realizuar pas paraqitjes së ankesës në Doganën e Kosovës. Këto transfere si prova të reja i ka dorëzuar gjykatës në kopje të mjaftueshme edhe për palën e paditur: transferet bankare të datës 09.09.2021, 24.08.2021, 14.04.2021, 06.04.2021, 03.08.2021, 22.06.2021, 02.09.2020 dhe 24.02.2021, ku është evidentuar numri i faturës së paguar. Meqenëse e paditura nuk i kishte këto dokumente në lëndë, dhe paditësi ka pasur afat pritje në pagesën e faturave, lënda është shqyrtuar në mungesë të tyre. Prandaj, konsideron se nuk është vërtetuar në mënyrë të plotë gjendja faktike në kuptim të dokumenteve të transaksionit që tani e posedon paditësi. Si rrjedhojë, konsideron se është i nevojshëm kthimi në rishqyrtim dhe rivendosje tek e paditura për të shqyrtuar kërkesën për rishqyrtimin e DUD-ve kontestues bazuar në dokumentet e transaksionit.

E paditura, në përgjigjen në padi të datës 27.10.2021, e ka kundërshtuar në tërësi padinë si të pabazuar. Ajo theksoi se aktvendimi i atakuar është marrë konform të gjitha dispozitave në fuqi, dhe pretendimet e palës paditëse nuk janë të vërtetuara me asnjë provë. Gjatë seancës së shqyrtimit kryesor, e paditura kundërshtoi padinë dhe kërkesëpadinë, duke mbetur pranë përgjigjes në padi dhe aktvendimit të Doganës së Kosovës, i cili refuzoi ankesën e paditësit si të pabazuar. Tutje ka shtuar se pretendimet e paditësit janë të pabazuara, pasi që gjatë administrimit të provave rezultoi se në sistemin Asycuda dhe në procedurën ankimore paditësi nuk ka paraqitur transferet bankare. Për këtë arsye, Dogana nuk ka mundur të veprojë ndryshe përveçse në kuptim të dispozitave ligjore të cekura në aktvendimin kontestues. Dogana, sipas nenit 35 të KDA-së, ka të drejtë të vlerësojë mallrat bazuar në fakte dhe prova, si në rastin konkret. Gjykatës i ka propozuar të refuzon kërkesëpadinë si të pabazuar dhe të lë në fuqi aktvendimin e të paditurës.

Për të vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike, Gjykata ka administruar provat në procedurën e shqyrtimit gjyqësor kryesor-publik të datës 12.06.2024 si në vijim: Vendimin nr.01.3.2.2/9474; 8088 të datës 30.06.2021, DUD-at kontestues, faturat përcjellëse, transferet bankare të datës 09.09.2021, 24.08.2021, 14.04.2021, 06.04.2021, 03.08.2021, 22.06.2021, 02.09.2020 dhe 24.02.2021, proceset mbi përcaktimin e vlerës së mallrave, ankesën në Doganën e Kosovës, dhe deklaratat eksportuese për disa nga DUD-at.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thëniet në padi dhe seancë, përgjigjen në padi, shkresat e lëndës në këtë kontest tregtar-administrativ, bëri vlerësimin e secilës provë veç

e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8, të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), dhe arriti në përfundimin se duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Në arsyetim të vendimit kontestues, e paditura ka mbështetur rivlerësimin e pranimit qendror, e cila vlerësimin e mallit e ka bërë bazuar në metodën e 6 të vlerësimit sipas nenit 35 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës, respektivisht në bazë të dhënave për mallrat e ngjashme dhe të dhënat e disponueshme të Doganës së Kosovës. Rivlerësimi i mallit është bërë bazuar në zhdoganimet e mëhershme dhe çmimet e tregut, të cilat janë konsideruar të besueshme për të pasqyruar vlerën e mallit lëndor. Nuk është kontestuese se subjekti në procedurë ka provuar të dëshmojë vlerën e transaksionit, por gjatë administrimit të provave rezulton se në sistemin Asycuda dhe në procedurën ankimore nuk janë paraqitur transferet bankare. Prandaj, Dogana nuk mund të veprojë ndryshe përveçse në kuptim të dispozitave ligjore të lartcekura, pasi subjekti ka paraqitur vlera tejet të ulëta në krahasim me vlerën reale të mallit kontestues.

Gjykata konstaton se e paditura nuk ka vërtetuar në tërësi gjendjen faktike të dokumentacionit përcjellës të mallit doganor, pasi nuk ka prova se e paditura ka shqyrtuar faturat edhe provat materiale të transferit bankar, me të cilin paditësi dëshmon se është paguar vlera e transaksionit konform nenit 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës 03/L-109. Paditësi ka paraqitur para gjykatës transferet bankare të datës 09.09.2021 BPB, në vlerë prej 3,961.04 €, transferin e datës 24.08.2021 BPB në vlerë prej 3,530.88 €, transferin e datës 14.04.2021 në vlerë prej 3,623.04 €, transferin e datës 06.04.2021 në vlerë prej 3,499.20 €, të cilat përmbajnë numrin e faturës GB78BOFA16505070293015. Gjithashtu, ka paraqitur transaksionet bankare të datës 03.08.2021 në vlerë prej 3,699.12 €, për faturën GB98BOFA16505070294013, transaksionin e datës 22.06.2021 në vlerë prej 3,088.80 €, atë të datës 02.09.2020 në vlerë prej 3,437.02 €, për faturën BG24uncr70001522537537, transaksionin e datës 24.02.2021 në vlerë prej 63,492.05 € për faturën ES3900815181030001047607, dhe deklaratat eksportuese nga BE, që kanë të njëjtën vlerë të mallit doganor.

Arsyetimin e të paditurës se paditësi nuk ka paraqitur transferet bankare, gjykata e konsideron të mangët, sepse sipas faturave lëndore konstatohet se paditësi ka pasur afat të pritjes deri në 90 ditë, dhe për këtë e paditura nuk ka dhënë arsyetim në vendimin e kontestuar.

Referuar nenit 33 par. 1 të KDAK-së, përcaktohet se: "*Vlera doganore e mallrave të importuara është vlera e transaksionit, që paraqet çmimin vërtetë të paguar ose të pagueshëm për mallrat e shitura për eksport në Kosovë, i përshtatur, sipas nevojës, në përputhje me nenet 36 dhe 37*", për gjykatën është e papranueshme që në procedurën administrative të ankesave të mos shqyrtohen në tërësi të gjitha pretendimet ankimore, nëse është paraqitur drejt vlera e mallit lëndor, arsyeja e mosparaqitjes së transfereve dhe dokumentacionit përcjellës. E paditura nuk i ka bazuar konstatimet e veta në asnjë dispozitë ligjore, kur e konsideron dokumentacionin e mallit si të pamjaftueshëm, dhe nuk është dhënë asnjë sqarim ligjor lidhur me pretendimin e paditësit se ka afat të pagesës, siç është dëshmuar në gjykatë kur janë paraqitur faturat për mallin lëndor, sipas të cilave shihet qartë se afati i pagesës është 90 ditë.

E paditura në rivendosje obligohet të shqyrtojë pretendimet e paditësit, të cilat i ka cekur në kërkesën për rishqyrtimin e vendimit të datës: R11138/30.04.2021; R11871/08.05.2021; R12449/14.05.2021; R12510/14.05.2021; R8858/08.04.2021; R9233/13.04.2021; R9683/17.04.2021; R9750/17.04.2021; RI9754/17.04.2021; R10088/21.04.2021; R10195/22.04.2021; R10196/22.04.2021; R10214/22.04.2021; R10427/24.04.2021; R10447/24.04.2021; R10457/24.04.2021; R11042/30.04.2021, të ZBD Ferizaj, për të verifikuar dokumentacionin përcjellës të mallit doganor të deklaruar sipas DUD-ve kontestues dhe të nxjerrë konstatimin nëse është paraqitur dokumentacioni i duhur dhe i harmonizuar në kuptim të vlerës së mallit lëndor që parasheh neni 123 i Udhëzimit Administrativ 11/2009 për implementimin e Kodit Doganor dhe të Akcizave.

E paditura në rivendosje obligohet të verifikojë dhe harmonizojë tërë dokumentacionin përcjellës si: faturat përcjellëse të mallit lëndor, transferet bankare, deklaratat eksportuese, dhe të vlerësojë nëse janë plotësuar kushtet ligjore për të aplikuar nenin 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës nr.03/L-109.

Gjykata, bazuar në autorizimet nga neni 43 par.2 të LKA-së, detyron të paditurën që në riprocedurë të veprojë sipas vërejtjeve të dhëna në arsyetim të këtij Aktgjykimi.

Vërejtjet e cekura janë të obligueshme për organin e paditur, duke u bazuar në nenin 65 të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Lidhur me shpenzimet e procedurës, gjykata vendimin si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi e ka bazuar në nenin 64 të LKA-së.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, Gjkata, konform nenit 43 par.2, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal
KF.nr.452/22, datë 12.06.2024

Gjyqtarja
Vera Gashi Bala

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj Gjykate.